



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

# Buletini

Publikim  
dymujor  
Viti XI  
Nr.69

Nëntor -  
Dhjetor  
2014

## Këshilli Kryetarëve kundërshton Koncept Dokumentin mbi Zhvillimin Rajonal në Kosovë



## Udhëheqja e AKK-së takon përfaqësuesit e SDC-së



## Roli i Drejtorive Komunale të Arsimit në monitorimin e cilësisë së arsimit



**Përfaqësuesit e AKK-së takohen me zyrtarë të lartë të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë**

## Përfaqësuesit e AKK-së takohen me zyrtarë të lartë të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë

Delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) i përbërë nga z. Naim Ismajli, Kryetar i AKK-së, z. Agron Kuçi, anëtar Bordi, znj. Mimoza Kusari Lila dhe z. Imri Ahmeti anëtar të Këshillit të Kryetarëve të AKK-së si dhe Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv i AKK-së, patën një takim pune me përfaqësuesit e Zyres Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE) përfaqësuar nga z. Christof Stock, Udhëheqës i Operacioneve në ZNKE, z. Libor Chlad, z/Kryesuesin e sektorit për bashkëpunim, z. Miha Pezelj, Udhëheqës i sektorit për ARDA si dhe z. Dardan Sadriu, udhëheqës i sektorit për EURED dhe bashkëpunim ndër-kufitar.

Gjatë takimit është vendosur që për fondet nga Instrumenti i para-anëtarimit të Komisionit Evropian komunat mund të aplikojnë për fonde drejtpërdrejtë në Komisionin Evropian e jo përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ashtu siç ka qenë deri më tani. Kjo tregon se besueshmëria në mes komunave dhe ZNKE është ngritur në nivel të lartë. Është dakorduar që ZNKE t'i

marë në konsideratë prioritetet e komunave të paraqitura në projekt propozime gjatë dhënies së granteve për komuna dhe gjithashtu të zbehet mundësia që për shkak elementeve teknike (p.sh përkthimi i dobët i projekt propozimit) komunat të penalizohen dhe të mos fitojnë grante nga fondet e Komisionit Evropian. Nëse komunat kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve të per-

sonelit lidhur me hartimin e projekt dokumenteve të cilat i plotësojnë standardet e kërkuara nga ZNKE, atëherë të e informojnë Asociacionin e Komunave të Kosovës.

AKK të jetë e kyçur në hartimin e Strategjisë së Konkurrencës, strategji kjo e cila do të hartohet nga Ministria e Integritimit Evropian.

Projektet me interes të zhvillimit ekonomik rajonal në Kosovë të hartohen duke ditur paraprakisht buxhetin e dedikuar për atë "rajon" (bazuar në ndarjen statistikore të AZHR-ve).

Konferenca e donatorëve për komuna të organizohet në partneritet të plotë në mes AKK-së dhe ZNKE-së. Shumë shpejt në ZNKE do vendoset lidhur me mundësin e përkrahjes së projektit të AKK-së rreth Zhvillimit Ekonomik Rajonal.

## Kryesuesit e Kuvendeve të Komunave të angazhuar në avancimin e politikave lokale

Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi takimin e radhës së Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave me qëllim të shqyrtimit të problematikave, evidentimin e pengesave të cilat hasin gjatë punës së tyre si dhe gjetjen e formave në tejkalimin dhe lehtësimin e punës së Kuvendit të Komunës në zhvillimin e politikave lokale.

Në këtë takim po ashtu u diskutua rreth gjetjeve të mundësive për pagesat e mëditjeve për anëtarët e komiteteve të Kuvendeve të Komunave si dhe për Udhëzimet Administrative të cilat fillojnë së zbatuari nga 1 janari i vitit 2015 për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Komitetin për Komunitete. Edhe gjatë këtij takimi, Kolegjiut i Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave ka



shprehur kërkesën lidhur me rritjen e mëditjeve e anëtarëve të Kuvendeve Komunale për 100 euro, si vendim që do të ndikoj në performancën dhe efikasitetin edhe më të madh të punës së Kuvendeve të Komunave.

"Ne si Kryesues të Kuvendeve të Komunave kemi kërkuar edhe më herët që mëditjet e anëtarëve të Kuvendit të rriten edhe për bazën që e kanë tani dhe unë mendoj që kjo patjetër duhet të ndodhë në mënyrë që Kuvendi të ketë më tepër seriozitet dhe të japin kontribut më tepër anë-

tarët e tij sepse kur ata e marrin një mëditje më të madhe, besoj që edhe më seriozisht punojnë që punët në komuna të ecin përpara" tha ndër të tjera Kryesuesja e Kolegjiut të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave znj. Valentina Bunjaku Rexhepi. Ajo shtoi se "kjo mëditje shtesë që ne kemi kërkuar nuk është e mjaftueshme, por duke e ditur që pjesa më e madhe e anëtarëve të Kuvendit punojnë edhe punë tjera, kjo rritje do të ishte e mjaftueshme në këtë kohë".



## Diskutohet 'Performanca Financiare dhe shërbimet e ofruara nga komunat për vitin 2013'

Nën organizim të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Zyrës së Auditorit të mbajtur Konferenca "Performanca financiare dhe ofrimi i shërbimeve në komuna në vitin 2013".



Në takimin ku morën pjesë Kryetarë të Komunave, Drejtorë Komunal për Buxhet e Financa dhe zyrtarë tjerë komunalë u paraqit për diskutim Dokumenti "Performanca Financiare dhe Shërbimi i ofruar në komuna në vitin 2013 (të dhëna krahasuese dhe indikatorë të performancës).

Qëllimi i përgatitjes dhe paraqitjes së këtij dokumenti u tha se është nisja e një debati rreth asaj se si mund të përdorën buxhetet komunale sa më mirë në shërbim të qytetereve, e cila

performancë matet me indikatorët kyq për të përmirësuar aktivitetet e përditshme financiare në komuna. Dokumenti mbulon tetë fusha të aktiviteteve financiare komunale.

Poashtu në këtë takim morën pjesë dhe u paraqiten me fjalimet e tyre ministri i Ministrisë së Financave z.Besim Beqaj, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal z.Besnik Osmani, Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Sazan Ibrahim, Zëvendës Auditori i

Përgjithshëm z.Artan Venhari dhe Drejtori i Departamentit të Buxhetit të Komunave në MF z.Petrit Popova.

Kryetarët e Komunave, Drejtorët Komunal dhe të pranishmit tjerë më pas diskutuan për Dokumentin e paraqitur duke dhënë këshilla dhe vërejtje për të përmirësuar këtë dokument (meqë ai është në diskutim) me theks në saktësimin sa më përmbajtësor të indikatorëve të tij, i cili do të rezultoj me të dhëna më të plota dhe reale.

## Vazhdojnë vizitat e udhëheqjes së AKK-së nëpër komuna

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli i shoqëruar edhe nga Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim po vazhdojnë vizitat nëpër komuna.

Këto vizita bëhen me qëllim të koordinimit të agjendës së veprimit lidhur me mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të komunave në mënyrë sa më të mirë të mundshme.

Kryetari Ismajli dhe Drejtori Ibrahim kanë vizituar kryetarin e komunës së Mitrovicës z.Agim Bahtirin dhe nënkryetarin e komunës së Skenderajt z.Faruk



Nura. Edhe në këto takime është biseduar për projektligjet aktuale të cilat Asociacioni i Komunave të Kosovës po lobon



për interesa të komunave të Republikës së Kosovës dhe çështjet tjera me rëndësi për qeverisjen lokale.

## Këshilli Kryetarëve kundërshton Koncept Dokumentin mbi Zhvillimin Rajonal në Kosovë



**Asociacioni i Komunave të Kosovës organzoi takimin e Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës për të debatuar lidhur me Draftin e Koncept Dokumentit mbi Zhvillimin Rajonal në Kosovë.**

Duke hapur takimin, kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli elaboroi Koncept Dokumentin e hartuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me Zhvillimin Rajonal në Kosovë. Kryetari Ismajli poashtu paraqiti para Kryetarëve të Komunave aktivitetet e Bordit të AKK-së që ka ndërmarë lidhur me këtë Koncept Dokument dhe qëndrimin që ka artikuluar Bordi pas analizimit të këtij Drafti.

Kryetari z.Naim Ismajli tha se gjatë takimit të Bordit të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) mbajtur më 31 tetor 2014 një ndër pikat e diskutimit ishte edhe shqyrtimi i projekt-koncept dokumentit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) mbi Zhvillimin Rajonal në Kosovë. "Bordi i AKK-së erdhi në për-

fundim se duke marrë parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e këtij procesi, AKK vlerëson se procesi i mëturjeshëm i hartimit të këtij dokumenti duhet të ndalohet deri në konstituimin e organeve të reja shtetërore të Republikës së Kosovës të dalura nga zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë. Poashtu hartimi i këtij dokumenti duhet të zhvillohet në partneritet të plotë me organet gjegjëse të Zyres Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë. Sa i përket zhvillimit dhe funksionimit të Agjencive për Zhvillim Rajonal (AZHR), AKK mendon që janë bërë shumë zhvillime pozitive në Kosovë dhe AKK mendon që proceset e tilla rreth AZHR-ve të cilat kthejnë këto zhvillime në pikën zero (0) nuk janë të nevojshme dhe të domosdoshme. Në përgjithësi, sa i përket këtij procesi dhe procesit të hartimit të politikave rajonale, Bordi i AKK-së mendon që për Kosovën nuk është momenti i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të filluar një proces të tillë".

Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së elaboroi pikat që vlerësohen se janë kontraktore mes vete në këtë Koncept Dokument duke potencuar tendencën e krijimit të një niveli të tretë qeverisës mes

nivelit qendror dhe atij lokal në Kosovë. Drejtori Ibrahimimi gjithashtu tha se tendenca e MAPL-së për të shtrirë dorën mbi Agjensitë Rajonale të Zhvillimit (AZHR) bie në kundërshtim me praktikën e rajonit.

Përkrahje qëndrimeve të Bordit për mospajtueshmëri me Koncept Dokument si ide, i dhanë edhe kryetarët e komunave në diskutimet e tyre si z.Imri Ahmeti – kryetar i komunës së Lipjanit, z.Shpend Ahmeti – kryetar i komunës së Prishtinës, znj.Mimoza Kusari – Lila – kryetare e komunës së Gjakovës, z.Sokol Haliti – kryetar i komunës së Vitisë, z.Refki Suma – kryetar i komunës së Hanit të Elezit, z.Haki Rugova – kryetar i komunës së Istogut, z.Bajram Mulaku – kryetar i komunës së Vushtrrisë dhe z.Sali Asllanaj – kryetar i komunës së Suharekës.

E përbashkëta e diskutimeve të Kryetarëve të Komunave ishte se është e nevojshme një trup koordinuese teknike për angazhime, projekte rajonale dhe bashkëpunime ndërkomunale (sikur Agjensitë Rajonale të Zhvillimit) por asesi nivel qeverisës në nivel të rajoneve brenda territorit të Kosovës.

## Rol me rëndësi në 'të bërit biznes' kanë dhënë edhe komunat e Kosovës



Sipas Raportit të fundit të Bankës Botërore për Kosovën, të prezantuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Kosova është ngritur në vendin e 75, sa i përket 'të bërit biznes', duke shënuar një ngritje të kon-

siderueshme nga vitet paraprake. Në këtë renditje një rëndësi kryesore i dhanë edhe angazhimet e komunave në dhënien e lejeve për ndërtim dhe procedurave të thjeshtëzuara nëpër administratën komunale.

Poashtu një rol me rëndësi pati edhe angazhimi i Asociacionit të Komunave të Kosovës rreth hartimit të Ligjit mbi Ndërtim, ku sipas Raportit të Bankës Botërore dhënia e lejeve për ndërtim është përmirësuar dukshëm, ku për 80 për qind është shkurtuar koha dhe janë ulur shpenzimet për regjistrimin, përkatësisht ndërtimin e objektit.

Në anën tjetër "një nga indikatorët që ka pasur më së shumti rritje për 58 vende prej vendit 100 ka rënë në vendin e 42 është indikatorit i regjistrimit të bizneseve, që është rritja më e madhe që ka ndodhur për këtë vit", ka thënë ministri i MTI-së z.Ismet Mulaj në prezantimin e këtij raporti, duke shtuar se ka edhe të arritura tjera të cilat janë domethënëse për të bërit biznes. Vlen të potencohet se për herë të parë që prej përfshirjes së Kosovës në raportin e Bankës Botërore "Të Bërit Biznes", Kosova shënon progresin më të madh në rangimit e kësaj liste, duke u ngritur për 28 pozita më lartë.

## Grupi joformal i grave në Kuvendin Komunal të Prishtinës vizitojnë AKK



Një delegacion i zgjeruar i Grupit Joformal të Grave në Kuvendin Komunal të Prishtinës kanë vizituar Asociacionin e Komunave të Kosovës ku janë pritur nga Drejtori Ekzekutiv z.Sazan Ibrahimimi me bashkëpunëtor. Duke folur në emër të këtij Grupi znj.Kimete Zeqa informoj përfaqësuesit e AKK-së lidhur me aktivitetin e tyre, sfidat me të cilat përballen dhe synimet për të ardhmen. Poashtu përfaqësuese të këtij Grupi në Kuvendin Komunal të Prishtinës kërkuan organizimin e një takimi mes kryesueseve të Grupeve Joformal të Grave në Kuvendet e Komunave në nivel të Kosovës për të shkëmbyer praktikat e mira e tyre. Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahimimi, pasi informoi të pranishmet me aktivitetin, strukturën dhe të arriturat e Asociacionit të Komunave të Kosovës, theksoi se Grupi Joformal i grave në Kuvendin Komunal të Prishtinës por edhe në komunat tjera duhet të japin kontributin e tyre në Planin e Veprimit Vjetor që janë duke e përgatitur Kuvendet e Komunave si një mekanizëm i mirë ku aty të reflektojnë dhe pasqyrojnë kërkesat dhe synimet e tyre për vitin e ardhshëm. Poashtu z.Ibrahimimi tha se AKK-ja është e gatshme të jetë mbështetëse e një takimi në mes përfaqësuesve të Grupeve të tilla në nivel të komunave të Kosovës.

## Hartohet model – Rregullorja për kushtet dhe mënyrën e veprimit me qentë dhe macet e braktisura dhe të humbura

Grupi punues i përbërë prej tre anëtarëve nga Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjor, Kryesuesi i Kolegjiumit të Shërbimeve Publike, përfaqësuesi nga Drejtoria për Shëndetësi e Komunës së Prishtinës, përfaqësuesi i Agjencionit të Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës dhe përfaqësuesi i Asociacionit të Komunave të Kosovës, morën pjesë në punëtorinë tre ditore për hartimin e "Model – Rregullores për kushtet dhe mënyrën e veprimit me qentë dhe macet e braktisura dhe të humbura". Ky dokument do të ju shpërndahen kolegjiumeve përkatëse dhe të gjitha komunave, pas lekturimit dhe përkthimit, e më pastaj kanë mundësi me dhënë rekomandime të gjithë zyrtarët që mundem me kontribuar që kjo model rregullore të begatohet edhe më shumë.



## Roli i Drejtorive Komunale të Arsimit në monitorimin e cilësisë së arsimit

**Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka organizuar përmes Kolegjiumit për Arsim, Konferencën me temën "Roli i Drejtorive Komunale të Arsimit në monitorimin e cilësisë së arsimit".**

Qëllimi i kësaj konference ishte që të diskutohet mbi rëndësinë e përgjegjësiave dhe obligimeve të Drejtorive Komunale të Arsimit në monitorimin dhe menaxhimin efikas të cilësisë së arsimit parauniversitar në nivel komunal dhe në nivel shkolle.

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli theksoi se duke marrë parasysh rëndësinë e arsimit të fëmijëve dhe të rinjve tanë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë në Kosovë, AKK / Kolegjiumi i Arsimit organizon këtë konferencë ku do të diskutohet mbi rëndësinë dhe përgjegjësitë dhe obligimet e Drejtorive Komunale të Arsimit në monitorimin dhe menaxhimin efikas të cilësisë së arsimit parauniversitar në nivel komunal dhe në nivel shkolle, roli i tyre në rritje në ballafaqimin e sfidave në proces të decentralizimit arsimor.

Kryetari Ismajli folin edhe për rëndësinë që shoqëria jonë duhet t'i jap arsimit dhe cilësisë së tij në të gjitha hallkat dhe sferat e tij. Kryetari Ismajli pasi falenderoi GIZ-in për përkrahje fushës së arsimit por edhe fushave tjera në nivelin lokal, rikonfirmoj qëndrimin dhe përkushtimin e komunave për një arsim cilësor dhe infrastrukturor në nivelin e autoriteteve lokale në Republikën e Kosovës. "Konsideroj që arsimi parauniversitar si një hallkë mjaft e rëndësishme e sistemit arsimor të jetë një segment prioritar për qeverinë e sapo krijuar, e mbështetet me qëllim që ajo të bëhet një bazë e shëndosh, kompetente dhe cilësore për një arsimim bashkëkohor universitar dhe konkurues në rajon. Për të realizuar këto objektivat që kemi para vetes për një arsim bashkëkohorë modern dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në realizimin e synimeve tona drejtë rrugës të Bashkimit Evropian, na duhet një përkushtim i gjithëmbarshtëm në punë dhe mësim. Andaj, shpresoj që edhe mbështetja e partnerëve zhvillimor në këtë drejtim nuk do të na mungojë" - tha ndër të tjera kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli.

Konferencë e përshëndeti edhe z.Xhavit Dakaj Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe znj.Diana Qarkaxhija - Kryesuese e Kolegjiumit për Arsim të AKK-së.

Në këtë Konferencë është prezantuar dhe disku-



tuar roli i tyre në rritje në ballafaqimin e sfidave në një proces të decentralizuar arsimor. Konferenca arriti të bashkoj akterë të rangut të lartë nga qeveria dhe sektori politik, arsimor dhe akademik, si dhe organizatat e shoqërisë civile. Në seancat e veta, Konferenca ofroj hapësirë për shkëmbim përvojash dhe praktikash të mira mbi rëndësinë e aspekteve monitoruese për përmirësimin e cilësisë në arsim. Poashtu programi i konferencës vuri në një platformë të rëndësishme adresimin e sfidave dhe mundësive në zhvillimin e menaxhimit të arsimit dhe në monitorimin e cilësisë së arsimit në këtë proces dinamik.

### **Në fund Konferenca doli me rekomandime dhe sfidat rreth fushave specifike:**

1. Zhvillimi i kapaciteteve në Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) për monitorimin (sigurimin) e cilësisë në arsim.
2. Rritja e rolit të Këshillave Drejtues të Shkollave, Këshillave të Prindërve dhe Këshillave të Nxënësve në sigurimin e cilësisë në arsim.
3. Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve në zbatimin e kurrikulës së re dhe vlerësimi i mësimdhënësve
4. Vlerësimi i nxënësve (vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i nxënësve).

## Udhëheqja e AKK-së takon përfaqësuesit e SDC-së

Udhëheqja e Asociacionit të Komunave të Kosovës, kryetari z.Naim Ismajli dhe Drejtori Ekzekutiv z.Sazan Ibrahimimi u takuan me znj.Brucchez Georgette - Udhëheqëse e Divizionit për Ballkanin Perëndimor në kuadër të Agjensisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) si dhe z.Laurent Ruedin - Menaxher i Programit për Kosove në Zyrën e SDC-së në Bernë.

Në këtë takim u debatua lidhur me situatën dhe zhvillimet në pushtetin lokal në komunat e Republikës së Kosovës dhe arritjet e deritashme.

Poashtu nga ana e udhëheqjes së Asociacionit të Komunave të Kosovës përfaqësuesit e SDC-së, u informuan lidhur me aktivitetet e deritashme të AKK-së sfidat dhe problemet me të cilat aktualisht ndeshet pushteti lokal në funksion të përmirësimit të mëtutjeshëm të shërbimeve komunale karshi qytetarëve të tyre.

Në këtë takim u bisedua edhe për synimet për të ardhmen të të dy organizatave dhe mundësitë e zhvillimit të bashkëpunimit.



## Lufta kundër stereotipeve dhe dezinformata në nivel lokal

Bruksel - Disa zyrtare të barazive gjinore të Komunave të Kosovës dhe përfaqësuesja nga AKK-ja morën pjesë në seminarin me temën: Barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut të personave LGBTI: lufta kundër stereotipeve dhe dezinformata në nivel lokal e organizuar në bashkëpunim me Komitetin e Rajoneve (Committee of the Regions) dhe NALAS-i (Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Jug-lindore. Qëllimi i këtij seminary ishte që përfaqësuesve lokale dhe rajonale të iu ipet mundësi të njihen me legjislacionin e BE-së dhe programeve mbi trajtimin e barabartë të burrave dhe grave, luftën kundër diskriminimit dhe të drejtat e personave LGBTI, si dhe mundësinë për t'i diskutuar zhvillimet e fundit në fushën e barazisë gjinore dhe luftën kundër diskriminimit të personave LGBTI në nivel të BE-së.

Aspekt i rëndësishëm i këtij takimi ishte shkëmbimi dhe mundësia rrjetëzimit ndërmjet pjesëmarrësve dhe institucioneve të tjera të nivelit evropian aktive në këto fusha.



## Shkurtimisht

- Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në takimin : “Prezantimi i fazës së dytë të projektit për fuqizimin e qëndrueshëm të pyjeve private dhe të decentralizuara në Kosovë” - bashkë financuar nga Qeveria Suedeze dhe CNVP.
- Përfaqësuesi i AKK-së mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga ‘Terre des Hommes’ në bashkëpunim me Zyrën Ligjore, pranë Kryeministrit ka organizuar punëtorinë “Kuadri rregullator për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë”;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës organizoi punëtorinë në Durrës për hartimin e Model - Rregullorës për kushtet e mbajtjes së qenëve dhe maceve dhe mënyrën e veprimit në rast braktisje dhe humbjes së tyre.
- Kolegjiumi i Zyrarëve Ligjor mbajti takimin e rradhës në dhjetor ku debatoi lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për procedurat e përgjithshme administrative dhe u bë shpërndarja e “Udhëzuesit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës” publikuar nga AKK-ja.

# Delegacioni i DKA-ve dhe MASHT-it në vizituan institucioneve arsimore në Slloveni

Delegacioni në përbërje të Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) nga data 16-21 nëntor 2014 vizituan institucionet arsimore në Slloveni, me qëllim të njohjes më të mirë të përvojave sllovene në kuadër të reformave arsimore, me theks të veçantë të njohjes së aspekteve të monitorimit së punës në shkollë nga nivelet arsimore në Slloveni. Vizita studimore u realizua në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve të Kolegjiumit të Arsimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës me mbështetje nga Programi Gjerman për Ngritjen e Kapaciteteve të Arsimit Fillor në Kosovë (NKAF) GIZ CDBE.

Gjatë qëndrimit njëjavor delegacioni i DKA-ve MASHT-it i vizitoi institucionet arsimore sllovene si Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe Sport të Sllovenisë, Departamentin për Arsim Parashkollor, Fillor dhe Arsimit për Fëmijë me Nevoja të Veçanta, Departamentin për kuadro në arsim; Departamentin për Mësimnxënie dhe Arsim, në Komunën e Lubjanës, Institutin



Kombëtar për Arsim në Slloveni, Qendrën Kombëtare për Vlerësime (Provime), Asociacionin Kombëtar të Këshillave të Prindërve si dhe Shkollën Kombëtare për (Drejtorë) - Udhëheqje në Arsim në Kranj. Mysafirët u njoftuan nga mikpritësit slloven me përvojat sllovene të niveleve arsimor gjatë procesit të reformave të mëdha dhe kursimet buxhetore që ka kaluar sistemi arsimor në fushat si zhvillimi profesional i mësimdhënësve, inspektimi, punësimi i stafit arsimor, vlerësimi i performancës së mësimdhënësve dhe avancimi në karrierë, vlerësimi i punës së mësimdhënësve, rregullimi i arsimit të obligueshëm, trajtimi i performancës së dobët të mësimdhënësve, emërimi dhe vlerësimi i punës së drejtorit të shkollës, regjistrimi i nxënësve në shkollë, bashkëpunimi i prindërve dhe shkollave, organizimi i bashkëpunimit të komunës me shkollë, si dhe monitorimi i punës së shkollës nga niveli komunal. Zyrtarët arsimor nga Kosova gjatë kësaj vizite u pritën gjithashtu edhe nga Ambasadori i Kosovës në Slloveni, z. Nexhmi Rexhepi, i cili u ofroi atyre përkrahjen e stafit të ambasadës sa herë që këto institucione e ndajnë nevojën për angazhimin e saj për të qenë urë lidhëse ndërmjet jo vetëm institucioneve qendrore por edhe atyre lokale të arsimit në Kosovë me institucionet e tilla në Republikën e Sllovenisë.

## AKK-ja organizon seminar me anëtarët e Kuvendit të Komunave

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me projektin DEMOS, po organizon seminar dy ditor, në 17 komunitat jo partnere të DEMOS-it. Seminari mbahet me anëtarët e Kuvendit të Komunës, rreth rolit të tyre mbikqyrës dhe në fokus ka Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe grupin e grave. Mekanizma këta, të cilët kanë rëndësi të madhe në funksionimin sa më të mirë të Kuvendit të Komunës. Seminari është mbajtur në Prizren dhe gjatë



këtyre tri javëve në vazhdim do të mbahet edhe në komunitat tjera. Inkurajomë anëtarët e Kuvendit të Komunave të marrin pjesë në këtë seminar me qëllim të shkëmbimit të mendimeve ideve dhe përvojave të mira.

## ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS BULETINI

Viti XI. Nr. 69 • Nëntor - Dhjetor 2014

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: [info@komunat-ks.net](mailto:info@komunat-ks.net)

Web: [www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

